IPKO Telecommunications LLC Prishtinë
Nr. 379 Ditë 10.02.2023

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër:	Ministria e Punëve të Brendshme, Departamenti i Prokurimit
Për Aktivitetin e Prokurimit:	Me numër të prokurimit 214-22-12273-1-1-1 dhe numër të brendshëm 214-22-119-111
Sa i përket tenderit për:	Lot1 Shërbimet – Furnizimet alternative beck-UP për VPN dhe Lot2 Internet për nevoja të IRK-së

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

IPKO Telecommunications L.L.C.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga Zija Shemsiu, nr. 34, Lagja Ulpianë
(Adresa)

Prishtinë — 10000
(Vendi) — *(Kodi postar)*

049/700-700 — N/A
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Arianit Duraku
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Arianit.duraku@ipko.com
(Adresa elektronike)

10.02.2023
(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

IPKO Telecommunications LLC Prishtinë

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Më datë 24.01.2023, në platformën elektronike të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (https://e-prokurimi.rks-gov.net/), është publikuar "Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, të datës 24.01.2023", lidhur me "Lot1 Shërbimet – Furnizimet alternative beck-UP për VPN dhe Lot2 Internet për nevoja të IRK-së, me numër të prokurimit 214-22-12273-1-1-1 dhe numër të brendshëm 214-22-119-111", me anë të së cilës, TelKos L.L.C. është shpallur tenderues i suksesshëm, me arsyetimin se, kjo e fundit ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët, në vlerë totale të ofertës për Lot1 në shumën prej 48.73€ i peshuar dhe për Lot2 në shumën prej 7,931.00€ i peshuar.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	X			**Jo**	☐

Procesi i hapjes së tenderëve është realizuar përmes platformës elektronike të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, e-prokurimi.

Pas hapjes së tenderëve, IPKO është njoftuar me procesverbalin e hapjes.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	X			**Jo**

IPKO, është vet-informuar përmes platformës elektronike e-prokurimi mbi Vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Në këtë drejtim, IPKO, brenda afatit ligjor, ka paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim pranë AK, i cili pastaj ka hedhur poshtë kërkesën për rishqyrtim të parashtruar nga IPKO.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 67, paragrafi 2: Autoriteti kontraktues e s'kualifikon çdo kandidat ose tenderues që nuk paraqet (iii) prova të mjaftueshme, sipas nenit 68 dhe 69 të këtij ligji, që në mënyrë të arsyeshme tregojnë së kandidati ose tenderuesi i plotëson kushtet minimale financiare, teknike dhe profesionale të përcaktuara në dosjen e tenderit ose në njoftimin e kontratës

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Përmes kësaj ankese, theksojmë se, arsyetimi i komisionit vlerësues të Autoritetit Kontraktues në "Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, të datës 24.01.2023", se tenderimi nga Operatori Ekonomik IPKO, është i papërgjegjshëm, në mungesën e dokumentacionit, gjegjësisht, dëshmisë së mjaftueshme, të cilat saktësojnë arsyeshëm se IPKO përmbushë kërkesat minimale të kapacitetit teknik/profesional, të saktësuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës, nuk mund të qëndroj. Për të saktësuar, pretendimet e Autoritetit Kontraktues se, referencat e dorëzuara nga IPKO nuk prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese në prezantimin e tyre, lehtësisht kanë qënë të identifikueshme, dhe atë, përmes kontakt personave të listuar si përfaqësues të referentëve, të cilët kanë lëshuar referencat në fjalë në favor të kësaj të fundit.

Për më tepër, arsyetimet e AK në Vendimin për Rishqyrtim të Kërkesës së IPKO-së, e datës 31.01.2023, se, IPKO nuk ka përfshirë në referencat e dorëzuara prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme

pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës së publikimit të Njoftimit për Kontratë dhe nuk përmbajnë vlerën e realizimit të Kontratave, janë të pa bazuara, kjo, konsideruar se, IPKO ka paraqitur në mënyrë të detajuar datat dhe vlerën e realizimit të Kontratave në Listat me projektet e Realizuara për Lot 1 dhe Lot 2, në të cilën janë bazuar referencat e lëshuara. Për më tepër, listat në fjalë, përveç përcaktimit të datës dhe vlerës, kanë diferencuar edhe shërbimet e kërkuara sipas grupeve Lot 1 dhe Lot 2, përkundrejt OE TelKos.

Provë 1: Listat me Projektet e Realizuara

Në anën tjetër, në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik, Neni 67, paragrafi 2, ekzistojnë dyshime të bazuara se, ofertuesi TelKos L.L.C. është përzgjedhur si fitues i aktivitetit të prokurimit, në relacion me Lot2, jashtë kritereve të cilat janë përcaktuar në Dosjen e Tenderit, gjegjësisht, specifikimeve teknike, të cilat përcaktojnë se, Operatori Ekonomik duhet të ofroj filtrim të trafikut, përmes DDoS Protection, i cili shërben për parandalimin e sulmeve kibernetike, përmes filtrimit të trafikut. Dyshimet e bazuara rrjedhin nga fakti se, aktualisht, në tregun e Kosovës, IPKO qëndron si operatori i vetëm ekonomik që mund të ofroj këtë shërbim, deri në kapacitetin e përcaktuar në dosjen e tenderit (40GB), për parandalimin e sulmeve kibernetike/trafikut. Ky fakt, për më tepër, mund të mbështetet nga vet Autoriteti Kontraktues, i cili, në momentin e sulmeve kibernetike të shkaktuara në vitin 2022 në Qeverinë e Kosovës, gjegjësisht, Ministrinë e Punëve të Brendshme, ka kontraktuar IPKO-në si ofrues të shërbimit apo solucionit DDoS Protection, me numër të kontratës 214-22-9682-2-3-5/C242, e cila, nga data e hyrjes në fuqi, ka parandaluar sulmet kibernetike, për të cilat, vet Autoriteti Kontraktues publikisht ka konfirmuar se ka pasur probleme të vazhdueshme para kontraktimit. Andaj, përkitazi me evidentimin në fjalë, mund të konstatohet se, vet Autoriteti Kontraktues do të mund të shërbente si referencë për konstatim të përmbushjes së kërkesave minimale të kapacitetit teknik/profesional, nga IPKO, në relacion me grupin Lot2. Theksojmë se, në momentin e kontraktimit të IPKO-së nga Ministria e Punëve të Brendshme, si ofrues të DDoS Protection, Operatori Ekonomik Telkos ka qenë i kontraktuar si ofrues i shërbimit të internetit. Pavarësisht kësaj, konsideruar se TelKos nuk ka ofruar solucionin DDoS Protection, apo kapacitetet teknike për të parandaluar trafikun e sulmeve kibernetike të shkaktuara, Ministria e Punëve të Brendshme ka kontraktuar IPKO-në, si operator shtesë, për ofrim të shërbimeve të internetit dhe solucionit në fjalë DDoS, pasi që, kjo e fundit, mbështetet në internet për të funksionuar. Një gjë e tillë mbi dyshime te bazuara sa i përket kriterit përkatës, vë në dilem nëse fituesi i aktivitetit të prokurimit ofron shërbimin sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues.

Për të përforcuar këtë qëndrim, pavarësisht pretendimeve tona në Kërkesën për Rishqyrtim, AK, nuk ka konsideruar fare pretendimet e IPKO-së në relacion me mungesën e shërbimit DDoS Protection, sipas paragrafit paraprak, përkitazi me dyshimet e bazuara.

Nga sa u tha më sipër, IPKO ka dorëzuar Kërkesë për Qasje në Dokumente Publike, pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, për qëllim të identifikimit të referencave të dorëzuara nga TelKos, gjegjësisht kapacitetit të kësaj të fundit që të ofrojnë shërbimin DDoS Protection, të përcaktuar në grupin Lot2. Ne kete drejtim, më datë 06.02.2023, IPKO ka siguar referencat e dorezuara nga OE pranë AK, në bazë të së cilave, janë evidentuar mos-përputhjet si vijon:

- *Referencat e dorëzuara nga OE përbëjnë konflikt interesi*: Konsideruar faktin se, kompanitë referente, ARD Holding L.L.C, AE Holding L.L.C., dhe Elektra L.L.C., si emër tregtar të regjistruar kanë, Telkos theksojmë se, referencat e dorëzuara për të mbuluar vlerën e kërkuar, përbëjnë konflikt

interesi, dhe si të tilla, nuk duhej pranuar nga AK. Korelakacion në këtë rast, prezanton dhe fakti se si aktivitet i regjistruar i të njejtave është, Aktiviteteti i telekomunikimit kabllor që vë në dilem dhe kredibilitetin e secilës referencë, fakt ky, i cili do të duhej paraprakisht të verifikohej nga ana e Autoritetit Kontraktues duke tentuar kështu që, në instancën më të lartë të evitohen situata që përfshijnë konfliktin e interesit.

Burimet nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë:

https://arbk.rks-gov.net/page.aspx?id=1,38,214132

https://arbk.rks-gov.net/page.aspx?id=1,38,608

https://arbk.rks-gov.net/page.aspx?id=1,38,211589

- *Referencat nuk janë valide, konsideruar se datat e tyre tejkalojnë datën e Njoftimit për Kontratë:* Nga referencat e dorëzuara nga Operatori Ekonomik TelKos, gjegjësisht, kompanitë referente, ARD Holding L.L.C, AE Holding L.L.C., dhe Elektra L.L.C., të cilat përbëjnë vlerën prej 1,017.106€, për qëllim të përmbushjes së vlerës së kërkuar, përbëjnë datën e lëshimit Dhjetor 2022, e cila datë, tejkalon datën e kërkuar shprehimisht nga AK, nga data e Njoftimit për Kontratë, për periudhën e shkuar trevjeçare. Pra, referencat e lëshuara nuk duhet të tejkalonin datën 14 Nëntor 2022.
- *Lista e dorëzuar nuk përkon me referencat e ofruara dhe nuk ndahet në Lote të caktuara:* Në gjithësej 17 referenca të definuara në tabelë, Operatori Ekonomik TelKos, ka ofruar 11 referenca, prej së cilave, 3 referenca (ARD Holding L.L.C, AE Holding L.L.C., dhe Elektra L.L.C.) duhet hedhur poshtë si rrjedhojë e arsyetimeve më sipër, ndërsa të tjerat, nuk ofrojnë fare detaje në relation me kërkesat e Loteve, gjegjësisht, ofrimin e shërbimeve DDoS Protection, pjesë përbërëse e kërkesave të Lot 2. Lehtësisht mund të konkludohet se, referencat e ofruara nga TelKos, nuk specifikojnë fare kapacitetet teknike/profesionale të kësaj të fundit, për të përmbushur kërkesat e Lot 2. Ndërsa, formati i tyre, përveç se nuk ndahet në dy grupimet e kërkuara për të dëshmuar kapacitetet teknike, nuk përkojnë fare me listën e dorëzuar, ku, për disa nga instituticonet financiare të përcaktuara në listë, nuk janë ofruar fare dëshmi nga OE.

Provë 2: Referencat e Dorëzuara nga OE TelKos, të siguruara nga AK

Andaj, nga sa u tha më sipër, kërkojmë nga OSHP, që të shqyrtoj ankesën e IPKO-së, duke anuluar "Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, të datës 24.01.2023" në relacion me Grupin Lot 2 dhe të iniciohet ri-tenderim për të njëjtin aktivitet, konsideruar se, OE i shpallur fitues i aktivitetit të prokurimit si më sipër, nuk përmbushë kerkësat e specifikuara në këtë grup, në relacion me kapacitetet teknike.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Theksojmë se, eliminimi i IPKO-së nga aktiviteti i prokurimit, në relacion me Lot2, shkakton dëmtime në fitimin e humbur.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/ kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*